



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:208810

Datë: 03.10.2024

Numri i dokumentit: 06245870

A.nr.2139/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçi dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses L.. M.. nga K., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit Nr.5003595 të datës 03.08.2021, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 16.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses L.. M.. nga K...

II. ANULOHET vendimi Nr.5003595 i datës 03.08.2021, i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Pensioneve me seli në Prishtinë dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt në kuptim të nenit 41 të LKA-së, me praninë e palës paditëse e në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësja me padinë e datës 20.09.2021, ka kërkuar anulimin e vendimit të marrë nga e paditura. Për më tepër, pohon se as organi i shkallës së parë dhe as organi i shkallës së dytë, vendimet e veta nuk i ka bazuar sipas dispozitave në fuqi dhe se komisionet e të paditurës nuk kanë marrë parasysh faktin se gjendja ime shëndetësore është e rëndë, se nuk jam e aftë për punë dhe se provat ekzistuese në komision, nuk janë marrë parasysh, për çka edhe gjendja faktike nuk u vërtetua në mënyrë të plotë dhe kjo pati për pasojë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale në dëmin tim. I propozon Gjykatës që padinë ta aprovoj si të bazuar dhe të anuloj vendimin e kontestuar me padi.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, paditësja deklaroi: *“Në këtë fazë të procedurës e precizoj padinë në aspektin objektiv sa i përket datës së vendimit i cili duhet të jetë 03.08.2021, gjithashtu kërkoj nga gjykata aprovimin e padisë si të bazuar dhe anulimin e vendimit të kundërshtuar me padi”*.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare, deklaroi: *“Gjykatës i propozoj aprovimin e padisë si të bazuar dhe anulimin e vendimit të kundërshtuar me padi”*.

E paditura me përgjigjen në padi të datës 09.11.2023 e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, duke pohuar se paditësja nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues i pensionit me aftësi të kufizuar të plotë dhe të përhershme, andaj i propozon Gjykatës që të marr Aktgjykim me të cilin e refuzon padinë si të pabazuar dhe lë në fuqi vendimin e të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: vendimi me numër 5003595 i dt.03.08.2021, vendimi i dt. 17.03.2021, raportet mjekësore dt.25.05.2021, 19.05.2021, 26.05.2021, 14.05.2021, 11.09.2019, 23.01.2016, 30.11.2020, 27.07.2018, 30.11.2020, vërtetimi i dt.06.05.2021, 12.06.2009, kërkesës për pension dt.14.12.2020, ankesa dt.07.05.2021, vlerësimi i komisionit mjekësor dt.23.02.2021, shqyrtimi i ankesë dt.02.07.2021.

Gjykata shqyrtoi provat e lartcekura dhe pretendimet e paditëses lidhur me kërkesëpadinë e saj dhe gjeti se padia është e bazuar.

Gjykata gjeti se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësja kishte aplikuar për t'ju njohur statusi i personit me paaftësi të përhershme.

Gjykata shqyrtoi dhe analizoi me kujdes aktin administrativ të kontestuar dhe për të njëjtin gjeti se arsyetimi është kontradiktor në raport me dispozitivin e vendimit.

Gjykata po ashtu konstatoi se e paditura me vendimin e kontestuar, nuk ka trajtuar qartë pretendimet ankimore të palës paditëse, ashtu që arsyetimi i vendimit nuk korrespondon me kërkesat specifike të palës paditëse dhe nuk përmban dëshmi mbi bazën e së cilave është refuzuar ankesa e paditëses.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative.

Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 të këtij ligji është paraparë Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar ashtu që akti administrativ i shkruar përmban: pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes, pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit, pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin) si dhe pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë. Nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj, akti administrativ i shkruar përmban emrin e mbiemrin e shkruar dhe nënshkrimin e nëpunësit përgjegjës gjegjësisht të kryetarit dhe të procesmbajtësit të organit kolegjial. Nëse procesmbajtësi ndodhet në pamundësi për të nënshkruar, në vend të tij nënshkruan një nga anëtarët e organit kolegjial. Kërkesa e nënshkrimit, sipas paragrafit 2 të këtij neni, në rastin e një dokumenti elektronik, do të vlerësohet e përmbushur nga një nënshkrim elektronik i kryer në pajtim me ligjin e posaçëm. Nënshkrimi elektronik duhet të bazohet në një certifikatë të

kualifikuar, në të cilën shprehet identiteti i organit publik përkatës. Qeveria e Republikës të Kosovës, me vendim të posaçëm, mund të përcaktojë një mënyrë tjetër të sigurt, që garanton autenticitetin dhe integritetin e dokumentit elektronik të dërguar dhe veçantitë e tij. Një dokument elektronik i garantuar në pajtim me një vendim të tillë të Qeverisë, do të vlerësohet, gjithashtu, si i nënshkruar.

Akti administrativ gjithashtu duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 48 të po të njëjtit Ligj, përcaktohet qartë se arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban një paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës, shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve, në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku, ndër të tjera thuhet se: *“Këshilli i Ankesave si organ i shkallës së dytë me ekspert mjekësor të lëmisë përkatëse duke vepruar sipas ankesës së z.znj.L.. M.. ka shqyrtuar në tërësi shkresat e lëndës në seancën e datës 02.07.2021, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit të shkallës së parë, në përputhje me paragrafin 5 të nenit 9 për PAK, dhe ka konstatuar-vlerësuar se nuk ka dokumentacion mjekësor të mjaftueshëm për të qenë përfitues i Pensionit për Persona me paaftësi të përhershme, prandaj Komisioni mjekësor i shkallës së dytë pajtohet me vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë që nuk janë plotësuar kriteret e parapara me ligj”*. Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura në arsyetimin e vendimit të atakuar nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme, nuk ka administruar asnjë provë nga e cila mund të vërtetohej fakti se paditësi nuk i plotëson kriteret e parapara ligjore për të fituar statusin e personave me paaftësi të përhershme.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Gjykata konstatoi se në këtë çështje administrative-juridike është shkelur ligji në dëm të paditëses, andaj organi i paditur do të ketë parasysh theksimet nga kërkesa e paditëses.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë Aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, u mor duke u bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e në kuptim të nenit 5, 6, 29, 38 si dhe nenit 46, paragrafit 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.2139/2021, datë: 16.09.2024

Gj y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj Gjykate.